

Prishtinë: 02.11.2007  
Kodi i ZRRE-së: D\_64\_2007  
Nr. I Referencës ERO/CPD\_R\_48\_10\_07

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
3. Ankesën e konsumatorit drejtuar Divizionit të Furnizimit - Departamenti për Konsumatorë i KEK Sh.A-së, e datës 12.04.2006;
4. Përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit - Departamenti për Konsumatorë, e datës 15.04.2006, dhënë konsumatori me datë 25.07.2006;
5. Kontratën e datës 27.07.2006 për pagimin e borxhit në shumën prej 5.706.92 €, e lidhur në mes të konsumatorit me shifër DPR-90038992 në emër të Lutfi Muqolli, në njërën anë dhe KEK Sh.A-së në anën tjetër.
6. Ankesën e konsumatorit drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në Zyrën e Rregullatorit për Energji me datë 27.07.2006, të regjistruar në DMK me nr 11/07.2006.
7. Kërkesën e ZRrE-së të datës 16.08.2006 drejtuar KEK Sh.A-së për plotësimin e dokumentacionit në lidhje me ankesën e konsumatorit të sipërpërmendur.
8. Njoftimin e datës 25.08.2006 nga ana e ZRrE-së drejtuar KEK Sh.A-së dhe konsumatorit mbi zgjatjen e afatit për 30 ditë lidhur me zgjidhjen e ankesës.
9. Shkresën e KEK Sh.A-së të datës 25.08.2006 bashkë me informatat e kërkuara nga ZRrE për konsumatorin e sipërpërmendur.
10. Përgjigjen e shpjeguar nga KEK Sh.A se pse është refuzuar konsumatori.
11. Vendimin D\_08\_2005 të ZRrE-së mbi miratimin e skemës së furnizimit ABC, pika 1d e vendimit;
12. Rekomandimi i DMK bërë Bordit të ZRrE-së, në pajtim me Nenin 14.5 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; të datës 19.09.2007 Nr. ZRrE/DMK\_R\_48\_10\_07; dhe
13. Neni 18 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 01.11.2007 morri këtë:**

## VENDIM

**PRANOHET** pjesërisht ankesa e konsumatorit Z. Lutfi Muqolli ”Mulliri Elektrik” - Bajqinë, nr. njehsorit 30653554 maksigrafi: 30653554, për arsyet e paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetimet

1. Konsumatori në ankesën e tij më datë 12.04.2006 ka bërë ankesë në KEK Sh.A për shkak se gjatë zbatimit të planit “ABC” ka qenë në kategorinë “C” dhe gjatë kësaj kohe kanë qenë shumë pakë të furnizuar me rrymë.
2. Me datë 15.04.2006 KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit në përgjigjen refuzuese dhënë konsumatorit thekson se: “deri në janar/2006 jeni duke u faturuar me lexim në muajin e 02/2006 keni faturim me “E”-mesatare dhe muaji i 06/2006 është me mesatare “E”, kështu që në muajin e 07/2006 duhet të lexoheni dhe të faturoheni me lexim të faturohen gjendjet reale”.
3. Me datë 27.07.2006 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A-së në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE.
4. Konsumatori në kërkesën e tij ka kërkuar që të shqyrtohet rasti i konsumatorit nga ZRrE ngase për shkak të reduktimeve të shpeshta të energjisë elektrike maksigrafi i konsumatorit nuk e ka bërë regjistrimin real.
5. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe me datë 16.08.2006 ka kërkuar nga KEK Sh.A dokumente shtesë, si dhe një arsyetim me sqarime më të qarta se pse është refuzuar ankesa e konsumatorit e datës 12.04.2006.
6. Me 24.08.2006 KEK Sh.A i përgjigjet ZRrE-së për konsumatorin Lutfi Muqolli duke sqaruar në mënyrë të qartë se pse e ka refuzuar konsumatorin me datë 15.04.2006. Përgjigja është si më poshtë:
  - 6.1. Sipas pikës 6 të Urdhëresës së ARRSHPK-së, KEK Sh.A ka zbritur tarifën për fuqinë e angazhuar në 30%.
  - 6.2. Konsumatori është i kyçur në daljen 10kV Letanci, me kod 050012, (ku janë edhe 1703 konsumatorë të amvisërisë), gjendet në kategorinë “B” dhe “C” për arsye se nuk është pagues i rregullt i energjisë elektrike, dhe se gjendet në zonën ku pagesa e energjisë elektrike nuk i plotëson kushtet për të qenë në kategorinë “A”.
  - 6.3. Konsumatori ka pasur njoftimin për shkyçje me datë 08.10.2005 pasi ka pasur borxh në vlerë prej 2,460.63€, pas kësaj konsumatori ka lidh kontratë për riprogramim të borxhit të cilën kontratë konsumatori nuk e ka përmbushur, për këtë arsye ka ndodh shkyçja me datë 29.03.2006 ku borxhi ka qenë 5,251.63€.
  - 6.4. KEK Sh.A ka aplikuar planin “ABC” i cili është i aprovuar nga ZRrE, dhe varësisht nga pagesa e energjisë elektrike zbatohet edhe plani “ABC”.
7. Me datë 25.08.2006 KEK Sh.A dërgon në ZRrE dokumentet shtesë për konsumatorin: kartelën e konsumatorit, faturat për periudhën prill 2005 - korrik 2006, ankesën e

konsumatorit, përgjigjen e parë të departamentit për konsumator të KEK Sh.A-së, përgjigjen në kërkesën e ZRrE-së.

8. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE gjatë analizës dhe shqyrtimit të bërë të dokumentacioneve të ofruara nga KEK-u dhe nga konsumatori si dhe shqyrtimit të dokumentacioneve shtesë të ofruara pas kërkesës Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE; ka propozuar Bordit të ZRrE-së që të pranoj pjesërisht ankesa e konsumatorit 11/07 2006 për arsye si në vazhdim:
  - 8.1. Prej muajit dhjetor 2005 (kur edhe ka filluar zbatimi i planit “ABC), deri në gusht 2006 ndërprerje për shkak të prishjeve dhe reduktimeve ka pasur 1,341.98 ore e 80,519 minuta (shih tabelën nr. 1 të bashkëngjitur).
  - 8.2. Për muajin dhjetor 2005, janar 2006 dhe mars 2006 (kur edhe ka pasur reduktime të rrepta nga KEK Sh.A) ZRrE ka llogaritur për konsumatorin 300 orë pune në muaj, (që i bie 10 orë në ditë, prej orës 08:00 deri në orën 17:00 - kohë e zakonshme e punës në një ndërrim), nga kjo del se për shkak të reduktimeve konsumatori ka mund të punoj vetëm:
    - 107.07 orë pune për muajin dhjetor 2005,
    - 83.37 orë pune për muajin janar 2006 dhe
    - 80.72 orë pune për muajin mars 2006.
  - 8.3. Nëse këtë shumë të orëve e llogarisim në % + 30 % bonitet të lejuar me tarifat që kanë qenë në fuqi deri me 1 maj 2007 që i referohet gjithashtu pamundësisë së furnizimit pa-ndërprerje dhe në këtë mënyrë shkakton një pjesëmarrje të rritur të fuqisë së angazhuar në çmimin e tarifës, atëherë do të kemi:
    - dhjetor 2005, janë 35.69 % orë +30 bonitet = 65.69 %
    - janar 2006, janë 27.79% orë +30 bonitet = 57.79 %
    - mars 2006, janë 26.91 % orë +30 bonitet = 56.91 %
  - 8.4. Korrigjimi i fuqisë në vlerën në € do të jetë: fuqia e shprehur në € përqindja nga paragrafi i mësipërm dhe kemi:
    - dhjetor 2005: nga 470.24 € korrigjim në 308.90 €
    - janar 2006: nga 473.46 € korrigjim në 273.61 €
    - mars 2006: nga 71.16 € korrigjim në 40.49.€
  - 8.5. Nga kjo shihet se diferenca që ZRrE i ka bërë konsumatorit për korrigjim është:
    - dhjetor 2005, gjithsej 161.34 €
    - janar 2006, gjithsej 199.85 €
    - mars 2006, gjithsej 30.67 €
  - 8.7. Për muajin shkurt, prill, maj, qershor, korrik, gusht 2006 fuqia është 0, pra nuk është faturuar fuqia, për këtë edhe nuk janë bërë korrigjime.
  - 8.8. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRrE-së, përgjigjen e KEK-ut për konsumatorin, dhe duke u

bazuar në Legjislacionin e Aplikueshëm në Kosovë, pranon pjesërisht ankesën e konsumatorit.

9. Më 01.11.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që **pranoj pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në pikën e 8 të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi konsumatori mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

**Kryesuesi i Bordit**

---

**Antarët e Bordit:**

---

---

---

---